

UDHËZIM
NR. 11, datë 10.9.2020

**PËR PROCEDURAT E MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË KONTRATAVE PËR
USHTRIMIN E AKTIVITETIT TË PESHKIMIT NË UJËRAT E BRENDSHME DHE
AKUAKULTURËN TOKËSORE DHE UJORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; pikës 16/1, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 31.1.2013, “Për përcaktimin e procedurave të konkurrimit publik për të drejtën e peshkimit në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

UDHËZON:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton procedurën që ndiqet gjatë procesit të monitorimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore.

2. Ndjekja e procesit të monitorimit të kontratave bëhet nga përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, si dhe nga Sektori i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës në ministri.

3. Në kuptim të këtij udhëzimi, Sektori i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Peshkimit dhe Akuakulturës është struktura përgjegjëse për peshkimin.

II. MONITORIMI I KONTRATAVE DHE DETYRAT E STRUKTURËS PËRGJEGJËSE PËR PESHKIMIN DHE TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE TË PESHKIMIT DHE AKUAKULTURËS

1. Struktura përgjegjëse për peshkimin në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës ndjekin në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të lidhura në përputhje me legjislacionin në fuqi të peshkimit dhe akuakulturës.

2. Struktura përgjegjëse për peshkimin mban regjistrin e kontratave të lidhura me ministrinë dhe për çdo kontratë të lidhur i dorëzon një kopje DSHPA-së.

3. Me lidhjen e kontratës për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme, struktura përgjegjëse për peshkimin dhe DSHPA-ja ushtrojnë monitorim të vazhdueshëm, në zonat që janë objekt i këtyre kontratave.

4. Objekt i monitorimit të zbatimit të kontratave është përputhshmëria e aktivitetit të subjektit me plan-biznesin e deklaruar gjatë procedurës së konkurrimit publik.

5. Gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave, verifikohet realizimi i programeve të investimeve dhe kontrollohet realizimi i investimeve në vite. Këto investime përfshijnë investime në infrastrukturë, investime rikonstruksioni, investime në mjetet e peshkimit etj., sipas treguesve të deklaruar në dokumentin e nivelit të investimeve apo plan-biznesin e paraqitur në aplikimin si kërkesë për leje të aktivitetit të ripopullimit të peshkimit.

6. Realizimi i investimeve të parashikuara në plan-biznes verifikohet nëpërmjet aktverifikimit të investimeve të dokumentuar dhe të plotësuar nga ana e investitorit dhe subjektit që ushtron aktivitetin. Këto investime duhet të jenë të shoqëruara me faturat tatimore përkatëse.

7. Struktura përgjegjëse për peshkimin dhe DSHPA kontrollojnë dhe verifikojnë numrin e të punësuarve në regjistrin themeltar të subjektit dhe sistemin tatimor, në përputhje me nivelin e punësimit të deklaruar në plan-biznes.

8. Monitorimi duhet të ketë si synim strukturën e llojeve të zënieve, sipas parashikimeve në kontratë, sasinë dhe periudhat përkatëse të zënieve të specifikuara në plan-biznes.

9. Gjatë monitorimit të zbatimit të kontratave, struktura përgjegjëse për peshkimin dhe DSHPA-ja verifikojnë nëse baza materiale dhe mjetet e përdorura për ushtrimin e aktivitetit janë të njëjtat me deklaratimet e bëra në plan-biznes.

10. Verifikimet dhe konstatimet e lartpërmendura duhet të pasqyrohen në një procesverbal të mbajtur dhe të firmosur nga të dyja palët.

11. Në kategoritë ujore të shpallura si zona bashkëmenaxhimi ku funksionojnë organizatat e menaxhimit të peshkimit (OMP), struktura përgjegjëse për peshkimin dhe DSHPA-ja monitorojnë zbatimin e kushteve të kontratës që ministria ka lidhur me OMP-në përkatëse.

12. Në zbatim të këtij udhëzimi, për kryerjen e çdo monitorimi kontrate, DSHPA-ja vendos në dispozicion Inspektoratin e Peshkimit dhe të dhënat/procesverbalet e kontrolleve të kryera nga inspektorët e peshkimit.

III. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Zbatimi i kushteve dhe i detyrimeve kontraktore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në fushën e peshkimit dhe akuakulturës.

2. Pas monitorimit të çdo kontrate, struktura përgjegjëse për peshkimin në ministri harton një raport të hollësishëm për respektimin e kushteve të secilës kontratë, shkeljet e konstatuara, rekomandimet përkatëse dhe ia paraqet Sekretarit të Përgjithshëm për miratim.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, si dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi